

**PROCESVERBAL DHE VENDIM I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME  
TE SHOQERISE AKSIONARE "SALUS TIRANA" SH.A.**

Sot, me 30/06/2010, ne oren 11.30, prane selise se Studios "Tonucci & Partners Albania" Sh.p.k. ne Rr. "Abdi Toptani", Torre Drin, K/2, Tirane, Shqiperi, ne prani te:

1. Z. Olti Peçini, qytetar shqiptar, lindur ne Tirane, me 19.08.1977, me banim ne Tirane, me pasaporte n. Z 0038339, ne cilesine e ortakut te Shoqerise Salus Tirana Sh.A. (ne vijim "Shoqeria"), zoterues i 55,68% (pesedhjetë e pese, 68 perqind) te kapitalit te Shoqerise dhe ne cilesine e Administratorit te Shoqerise;
2. Shoqeria Policlinico Triestino S.p.A, shoqeri e se drejtes italiane, zoteruese e 32,95% (tridhjetë e dy, 95 perqind) te kapitalit te Shoqerise, perfaqesuar ne kete mbledhje nga z. Franco Stock, qytetar italian, lindur me 24.06.1963 ne Trieste, Itali, me banim po aty ne Via Cattedrale n. 5, me karte identiteti italiane n. 2115088AA;
3. Shoqeria Finest S.p.A, shoqeri e se drejtes italiane, zoteruese e 11,36% (njembdhjetë,36 perqind) te kapitalit te Shoqerise, e perfaqesuar ne kete mbledhje nga z. Fulvio Betrame, qytetar italian, lindur me 27.08.1945 ne Venezia, Itali me banim po aty ne Via Dorsoduro (Venezia), 737 me karte identiteti italiane n. AK1439492, i pranishem ne mbledhje nepermjet telekonferences,
4. Z. Davide Gregori, qytetar italian, lindur me 15.10.1968 ne Trieste, Itali me banim po aty ne via Rossetti 59, me pasaporte italiane nr. Y 181041 me cilesine e Administratorit te Shoqerise.

\*\*\*\*

Merr persiper drejtimin e Asamblese Z. Franco Stock, i cili pasi konstaton prezencen e ortakut qe perfaqeson 55,68% te kapitalit te Shoqerise, dhe te ortakut qe perfaqeson 32,95% te kapitalit te Shoqerise, dhe te ortakut qe perfaqeson 11,36% te kapitalit te Shoqerise, e delkaron asamblene si te mbledhur sipas rregullave dhe te afte te mare vendime mbi rendin e dites, e pasi ka thirrur z. Davide Gregori – i cili pranon – te beje Sekretarin,

**e deklararon**

Asamblene te mbledhur rregullisht dhe te afte per te vendosur mbi rendin e dites sic vijon:

**A. Rritja e kapitalit te Shoqerise.**

- a. Modalitetet e rritjes se kapitalit nepermjet emetimit te aksioneve te reja.
- b. Kufizim i mundshem i se drejtes se ortakeve ekzistues per te ushtruar te drejten e parablerjes mbi aksionet e emetuara rishtazi dhe shprehje e pelqimit ne menyre fomale per nenshkrimin e tyre, nga ana e njerit prej ortakeve.
- c. Miratimi i mundshem i perberjes se re te ortakerise se shoqerise dhe i ndryshimeve ne Statutitn e Shoqerise.

Fillon te trajtohet pika e pare e rendit te dites.

## A. Rritja e kapitalit te Shoqerise.

Kryetari i paraqet Asamblese se ne funksion te investimentit qe do te kryhet per ndertimin e spitalit, eshte e nevojshme qe te rritet kapitali i shoqerise nga ai qe eshte aktualisht prej **Euro 4.400.000** (kater milion e katerqind mije Euro), i barazvlefshem ne ALL 595.116.000 Lekë ne **Euro 4.900.000** (kater milion e nenteqind mije Euro), i barazvlefshem ne ALL 662.916.000 Lekë, i cili do te realizohet nepermjet rritjes se numrit te aksioneve.

Kryetari informon se rritja e kapitalit te Shoqerise me 500.000 (pese qind mije) Euro, do te kryhet nepermjet emetimit te aksioneve te reja te cilat do te shlyhen nepermjet kontributeve ne para nepermjet emetimit te aksioneve te reja.


Ne kete kuader, Kryetari informon Asamblene per interesimin qe ka treguar shoqeria **Finest S.p.A.** per te rritur pjesemarrjen e saj ne kapitalin e Shoqerise.

Av. Muçaj informon Asamblene se ne rast se ortakët ekzistues kane per qellim qe te pranojne rritjen e pjesemarrjes se **Finest S.p.A.** ne Shoqeri, ata duhet te shprehen permes votes se heqin dore nga e drejta e parablerjes mbi aksionet e emetuara rishtazi.

Pas nje diskutimi te gjere Kryetari fton ortakët te shprehen me votim ne lidhje me sa me siper, dhe konstaton voten pro te ortakut **Policlinico Triestino S.p.A.** dhe voten pro te ortakut **Peçini**, dhe voten pro te ortakut **Finest S.p.A.**, prandaj Asambleja me shumice absolute:

### vendosi

- i.) te rrise kapitalin e shoqerise nepermjet rritjes se numrit te aksioneve me 500.000 (peseqind mije) aksione, baraz me vleren ne **Euro 500.000** (peseqind mije Euro) e barazvlefshme ne ALL 67.800.000 Leke, (Vlera nominale e nje aksioni eshte e barabarte me Euro 1,00 (nje/00) e barazvlefshme ne ALL 135,6 Leke), te cilat do te shlyhen nepermjet kontributeve ne para te ortakut ekzistues **Finest S.p.A.** qe do te kryhet nepermjet derdhjes nga Fondo Balcani.
- ii) **Policlinico Triestino S.p.A** heq dore nga e drejta e parablerjes per numrin e aksioneve qe i takojne ne proporcion me kuoten e tij, ne rritjen e kapitalit te vendosur;
- iii) **Olti Pecini** heq dore nga e drejta e parablerjes per numrin e aksioneve qe i takojne ne proporcion me kuoten e tij, ne rritjen e kapitalit te vendosur;
- iv) Ne vijim te sa me siper, ortakut **Finest S.p.A.** nenshkruan rritjen e kapitalit te Shoqerise nje numer prej 500.000 (pese qind mije) aksionesh baraz me vleren ne **Euro 500.000** (peseqind mije Euro), ekuivalente ne ALL 67.800.000 Leke, (Vlera nominale e nje aksioni eshte e barabarte me 1,00 (nje/00) Euro, e barabarte me ALL 135,6 Leke), te cilat do te shlyhen teresisht nepermjet kontributeve ne para te ortakut ekzistues **Finest S.p.A.** qe do te kryhet nepermjet derdhjes nga Fondo Balcani.
- vi) Te aprovoje perberjen e re te ortakerise se shoqerise dhe ndryshimin e nenit 5.1 të Statutit të Shoqërisë sipas tekstit në vijim



"Neni 5.1

5.1 Kapitali i Shoqërise teresisht i nenshkruar dhe i derdhur është Euro 4.900.000 (katërmilion e nentëqind mijë Euro) i barazvlefshëm me 662.916.000 Leke (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e nentëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë Leke) i cili përbehet nga 4.900.000 (katërmilion e nentëqind mijë) aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1 (Një) Euro secili. Kapitali është nenshkruar dhe paguar si më poshtë:


- Shoqëria Policlinico Triestino S.p.A, zoteron 1.450.000 (një milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) aksione të cilat përbejnë 29.59 % (njëzet e nëntë, 59 për qind) të kapitalit të Shoqërise, për një vlerë në para prej Euro 1.450.000 (një milion e katërqind e pesëdhjetë mijë);
- Z. Olti Peçini zoteron 2.450.000 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) aksione të cilat përbejnë 50.00% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërise, për një vlerë në para prej 2.450.000 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) Euro;
- Shoqëria Finest S.p.A, zoteron 1.000.000 (një milion) aksione, të cilat përbejnë 20,41% (njëzet, 41 për qind) të kapitalit të Shoqërise për një vlerë në para prej 1.000.000 (një milion) Euro.

\*\*\*


Duke mos patur asgjë tjetër për të vendosur, Kryetari e deklaroi të shpërndarë Asamblenë në orën 12.30. Ky procesverbal është i redaktuar në 6 (gjashtë) kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe italiane.

Firmat:

Kryetari

  
z. Franco Stock

Sekretari

  
Z. Davide Gregori

Ortakët

Per Policlinico Triestino S.p.A

z. Olti Peçini

PERKTHYESI

NOTERI





